



100 Vjet Pavarësi

FESTIVALI I 13^{të} I FILMIT SHQIPTAR

3-9 Nëntor 2012

Stafi i Festivalit të 13-të të Filmit Shqiptar/Staff 13th Festival of Albanian Film

Drejtor/Director Artan Minarolli

Producent/Producer Mediavision

Komisioni për zgjedhës i filmave/Film Selection Committee:

Esat Musliu, Kristaq Mitro, Eno Milkani

Kordinatorë/Co-ordinator: Thomas Logoreci, Iris Elezi

Marrëdhëniet me shtypin/Press Relations Oliverta Lila

Stafi mbështetës/Support Staff:

Arben Lami, Shqiponja Dauti, Marjela Zajmi, Mimoza Bylyku, Majlinda Tafa
Artan Lipivani, Endri Neziri, Elonia Gjata

Design & Layout Grafika Elzana

© QKK / ANCC

**PËRSHËNDETJA E KRYEMINISTRIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
PROF.DR. SALI BERISHA
DREJTUAR KINEASTEVE, PUBLIKUT DHE ORGANIZATORËVE TË
FESTIVALIT TË 13^{të} TË FILMIT SHQIPTAR**

Të nderuar miq kineastë!

Të nderuar dashamirës të artit dhe kulturës!

100 Vjetori i Pavarësisë së Shqipërisë vjen bashkë me historinë e artit më të ri dhe më popullor në botë; Artit të Kinematografisë. Pas vëllezërve Lumier dhe vëllezërve Manaki, që të parët themeluan filmin në Ballkan dhe i dhanë njerëzimit këtë mrekulli, edhe shqiptarët ishin ndër të parët që e adhuruan këtë art të ri, e përqafuan atë me entuziazëm, duke hapur qysh në vitet '20 të shekullit të kaluar, kinematë e para në të katër anët e vendit.

Pjesë e historisë në këtë përvjetor të madh të Pavarësisë së Shqipërisë, është edhe historia e kinematografisë sonë, që ka regjistruar nëpër kronika, dokumentarë e filma artistikë historinë, problemet sociale, karakterin dhe mentalitetin e popullit tonë. Historia shqiptare, civilizimi shqiptar nuk mund të kuptohen pa kinemanë që u bë lejtmotiv i shpirtëror për këtë popull, përgjatë gjithë historisë së mbijetesës së tij.

Periudha e errësirës gjatë viteve të diktaturës solli politikat antihumane të realizmit socialist, duke ndrydhur frymën dhe vizionin e lirë, solli artin shabllon që duhej t'i shërbente ideologjisë komuniste, solli izolimin total, burgosi krijimtarinë e lirë dhe dogmatizoi çdo shprehje artistike.

Sot ky art po luan një rol të rëndësishëm në regjistrimin e kohës që po jetojmë, po transmeton në mënyrë emocionale pulsën e jetës, energjinë e dialektikës së zhvillimit dhe ajo që është më e rëndësishmja, analizon thellësisht një shoqëri që lufton përditë për hapësira të reja e që aspiron të ndërtojë të ardhmen Europiane që meriton.

Festivali i 13^{të} i Filmit Shqiptar është një ngjarje e shënuar për kinematografinë tonë, një ndalesë për të analizuar vlerat, për të kujtuar e përgëzuar të gjithë ata që i kanë dhënë shpirtin këtij arti të madh dhe që vazhdojnë t'i japin një emër të mirë Shqipërisë nëpër festivale ndërkombëtare.

Shpreh mirënjohjen time për mundësinë që më dhatë që të jem pranë jush, duke e cilësuar Festivalin e 13-të të Filmit Shqiptar "Nën përkujdesjen e veçantë të Kryeministrit të Shqipërisë". Ju siguroj për mbështetjen dhe vlerësimin tim në punën tuaj fisnike, për të zhvilluar artin kinematografik dhe për ta kthyer atë në pasqyrë të ndërgjegjes sonë kombëtare.

**Përzemërsisht
SALI BERISHA**

**GREETINGS FROM THE PRIME MINISTER OF THE REPUBLIC OF ALBANIA
PROF. DR. SALI BERISHA
TO THE CINEASTES, PUBLIC AND ORGANIZERS OF
THE '13th FESTIVAL OF ALBANIAN FILM IN THE 100th INDEPENDENCE YEAR'**

Dear Honorable Art and Culture Lovers!

This 100th anniversary of Albania's independence coincides with the history of the newest and most popular art form: motion pictures. The Lumiere Brothers were followed by the Manaki Brothers, who gave the world a never seen before dimension, becoming the first to bring this unique art from to the Balkans. Albanians adored this new art, embraced it wholeheartedly and opened up cinemas everywhere as early as 1920.

Part of the history in this grand centennial of Albania's independence also spans the history of our cinema heritage which were recorded through newsreels, documentaries, and fiction features that captured the history, the social problems, the character and the mentality of our people. Albanian history going back to our earliest civilization can't be understood without the cinema which has become a spiritual leitmotiv through our past century of survival.

The dark period during the dictatorship years brought forth the inhuman politics of socialist realism which suffocated individual visions, and fresh perspectives, relying on officially approved art to serve the communist ideology of total isolation imprisoning creativity and freedom of expression.

Today this art form plays a vital role in recording the changing times in which we live, emotionally transmitting the pulse of our lives, the energetic dialectics of development, and, most importantly, presents a deep analysis of everyday society which moves toward new horizons, aspiring to build the European future we deserve.

The '13th Festival of Albanian Film in the 100th Independence Year' is an important event for our country's cinema, a moment to analyze our values, to remember and congratulate all those who have dedicated their lives and souls to this art and that they continue to give a good name to Albania in festivals and competitions worldwide.

I would like to express my gratitude for the opportunity you have given me to be with you by proclaiming this '13th Festival of Albanian Film in the 100th Independence Year' open under the auspices of the Albanian Prime Minister. I would like to assure you of my continued support and for your noble profession to develop this art form further and turn it in to a mirror of our national consciousness.

Sincerely
SALI BERISHA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE




A New Mediterranean Love

www.albaniantourism.com www.akt.gov.al



Albania 





RG RAJFI SH.P.K.

import - eksport - konstruksione

Adresa: Lagja nr. 4; Rruga "Enver Zazani" Durrës

Email: sales@rajfi-group.com

Tel: (zyra e shitjes) +355 52 234 999

Mob: (zyra shitjes) +355 69 60 71 514

Fax: +355 52 234 333


www.rajfi-group.com

PËRMBAJTJA / CONTENTS

PËRSHËNDETJE E KRYEMINISTRIT / PRIME MINISTER'S GREETING	3
PRESIDENTI I FESTIVALIT / FESTIVAL PRESIDENT	8
HISTORI E SHKURTËR E FILMIT SHQIPTAR / SHORT HISTORY OF ALBANIAN CINEMA	10
QKK/ANCC	12
FINANCUES DHE MBËSHTETËS / FINANCE AND SUPPORT	13
SHFAQJE E VEÇANTË - NËNTORI I DYTË/ SPECIAL SCREENING—THE SECOND NOVEMBER	14
FILMI I HAPJES - ANIJA / OPENING NIGHT - THE SHIP	16
FILMI I MBYLLJES - BESA: PREMTIMI / CLOSING NIGHT - BESA: THE PROMISE	18
JURIA E FILMIT ARTISTIK TË GJATË / FEATURE FILM JURY	20
JURIA E FILMT TË SHKURTËR, DOKUMENTAR & VIZATIMOR / SHORT, DOCUMENTARY & ANIMATION JURY	23
FITUESIT E MËPARSHËM / PREVIOUS WINNERS	25
FILMA ARTISTIKË / FEATURE FICTION	27
FILMA TË SHKURTËR / SHORT FICTION	45
FILMA DOKUMENTARË / DOCUMENTARY	67
FILMA VIZATIMORË / ANIMATION	87
FILMAT E STUDENTËVE / STUDENT FILMS	96
SPONZORËT DHE PARTNERËT / SPONSORS & PARTNERS	120

ROBERT NDRENIKA – President i festivalit

ROBERT NDRENIKA – Festival President



Festivali i 13^{të} i Filmit shqiptar në këtë 100- Vjetor të Pavarësisë ka nderin të ketë President të Festivalit aktorin e mirënjohur Robert Ndrenika, prezenca e të cilit në ekran dhe skenë ka dhënë një kontribut të vlefshëm për kulturën shqiptare.



Lindur në 1942, aktori i teatrit dhe i filmit Robert Ndrenika është një prej legjendave të skenës dhe ekranit shqiptar. Për pothuajse gjysëm shekulli interpretimet e tij kanë qenë të papërsëritshme, si në dramë dhe në komedi.

Ndrenika i kreu studimet në degën e dramës në Shkollën e Lartë të Aktorëve “Aleksandër Moisiu” në Tiranë, në fillim të viteve 1960. Më vonë Ndrenika dhe iu bashkua teatrit “Skampa”. Më vonë u vendos në Tiranë si aktor pranë Institutit të Lartë të Arteve dhe me pas në Teatrin Popullor. Ndrenika punoi me pedagogët e shquar të Teatrit Shqiptar, Kujtim Spahivogli dhe Mihallaq Luarasi.

Born in 1942, theater and film actor Robert Ndrenika is one of the living legends of Albanian stage and screen. His nearly half century of intense dramatic roles and masterful comic performances is virtually unparalleled.

Ndrenika's acting career began at the Alexander Moisiu University in the early 1960's. Eventually Ndrenika moved on to Elbasan's 'Skampa' theater before finding his way to Tirana, first as a young player at the Institute of High Arts and then at the National Theater. He was fortunate to work with esteemed professors of Albanian theatre such as Kujtim Spahivogli and Mihallaq Luarasi.

Since his 1966 appearance in Hysen Hakani's OSHËTIMË NË BREGDET, Robert Ndrenika has acted in over thirty feature films, short fictions and television movies.



Që nga shfaqja e tij në ekran në OSHËTIME NË BREGDET të Hysen Hakanit (1966), Robert Ndrenika ka interpretuar në mbi tridhjetë filma artistik të gjatë, të shkurtër dhe televizivë.

Lista e regjisorëve me të cilët ka bashkëpunuar Ndrenika si protagonist dhe në role dytësore nis me pionerët e kinemasë Dhimitër Anagnosti (NË SHTËPINË TONË), Viktor Gjika (RRUGË TË BARDHA), Saimir Kumbaro (KONCERT NË VITIN 1936) me Piro Milkani (SHTIGJE LUFTE) Muharrem Fejzo (MËSONJËTORJA) dhe vazhdon me brezin e kineastëve të rinj, Fatmir Koçi (TIRANA VITI ZERO), Gjergj Xhuvani (PARRULLAT) dhe Artan Minarolli (KRONIKË PROVINCIALE).


Gjatë kësaj periudhe dyzetvjeçare Robert Ndrenika ka sjellë për publikun tonë plot dritë dhe zgjuarsë në dramën e William Shakespeare, Bertold Brecht, Vladimir Mayakovsky, Sami Frashëri, Ruzhdi Pulaha, Ismail Kadare dhe Dritëro Agolli. Lista është e gjatë...

The list of directors who have cast Ndrenika in lead and supporting roles runs the gamut from cinema pioneers Dhimitër Anagnosti (NË SHTËPINË TONË), Viktor Gjika (RRUGË TË BARDHA), Piro Milkani (SHTIGJE LUFTE) to post-socialist craftsmen Fatmir Koçi (TIRANA YEAR ZERO), Gjergj Xhuvani (SLOGANS) and Artan Minarolli (ALBANIAN CHRONICLE).

During his illustrious forty year stage career Robert Ndrenika has performed the works of William Shakespeare, Bertold Brecht, Vladimir Mayakovsky, Sami Frashëri, Ismail Kadare and Dritëro Agolli. The list goes on.

Apart from his duties as Festival President, Ndrenika can be seen in the restored version of Viktor Gjika's THE SECOND NOVEMBER, our opening night premiere event.

The '13th Festival of Albanian Film in the 100th Independence Year' is proud to honor Robert Ndrenika, whose stage and screen presence forever changed the face of Albanian culture.



HISTORI E SHKURTËR E KINEMASË SHQIPTARE

A SHORT HISTORY OF ALBANIAN CINEMA

Historia e Kinemasë Shqiptare lidhet me një kulturë të hershme e cila lulëzoi qysh me lindjen e kinematografisë botërore. Jehona e vellezërve Lymier u përhap si një rrezatim i shpejtë i një arti në lindje e sipër edhe në Ballkan me anë të Vëllezërve me origjinë shqiptare Manaki, të njohur si “Lymierët e Ballkanit”. Në vitin 1909 Kol Idromeno shfaqti për herë të parë një film në Shkodër. Më pas filmat e huaj të atyre viteve filluan të shfaqen në kinematë e qyteteve kryesore të Shqipërisë. Në vitin 1943 regjisori shqiptar Mihallaq Mone xhiroi për herë të parë në Pogradec një film artistik 10 minutësh i titulluar TAKIM NË LIQEN në të cilin interpretonin aktoret Merita Sokoli, motrat Xhaçka dhe aktori i njohur shqiptar i atyre viteve në Rumani, Kristaq Antoniu. Në fillim të shek. 20 shpërbërja e Perandorisë Osmane solli ciklime luftrash dhe betejash politike për të rivendosur kufijtë. Në këto situata, kur territori Shqiptar u bë shesh betejash të luftrave ballkanike, Luftës së Parë dhe të dytë Botërore, operatorë të huaj, që shoqëronin ushtritë apo kalonin për të pasqyruar kaosin luftarak që sundonte në gjithë rajonin, kanë lënë xhirimet e tyre si dëshmi e atyre kohërave. Disa prej këtyre materialeve të rralla ndodhen sot në Arkivin Qendror Shtetëror të Filmit. Kronika më e hershme është ajo e vitit 1911 që pasqyron rrethimin e Shkodrës nga ushtritë Malazeze dhe pasohet nga kronikat e ardhjes së Princ Vidit në Shqipëri, si dhe ato me pamje nga Tirana dhe Durrësi.

Prodhimi kinematografik vendas filloi në vitin 1947 me themelimin e Ndërmarrjes Kinematografike e cila nisi xhirimet e kronikave, suzhetëve e kinoditarëve. Industria e filmit të

The story of Albanian cinema is related to the ripple effect generated by the birth of the seventh art form itself. The brothers Lumière invention quickly echoed in the Balkans through the pioneer work carried out by the Manaki brothers, of Albanian origin, also known as the Lumière brothers of the Balkans. In 1909, Kol Idromeno was the first Albanian ever to screen a motion picture in Shkodra. Later on, foreign films were commonly shown in the theaters of Albania's main cities. In 1943, director Mihallaq Mone shot a 10-minute long motion picture for the first time in Albania, in Pogradec. It was entitled A MEETING AT THE LAKE and featured actors such as Merita Sokoli, the Xhaçka sisters and then-renowned Albanian actor from Romania Kristaq Antoniu. At the start of the 20th century, the collapse of the Ottoman Empire brought disarray into the Balkans, as nations scrambled to redefine their borders. As the Albanian territory became a battleground for the Balkan Wars during the First and Second World Wars, foreign film operators embedded in their respective armies, were sent over by news agencies to document the mayhem in the area and captured footage that stands out as priceless evidence of those chaotic times. Some of this rare footage can be found today in Albania's Central Film Archive. The earliest film account goes back to 1911 and shows scenes from the siege of Shkodra by the Montenegrin army. There is also documentary footage of Prince Wied's arrival in Albania and early scenes from Tirana and Durrës.

Albanian organized national film production began in 1947, as the National Filmmaking Enterprise was founded, which promptly started producing documentaries, newsreels and reports. As the

gjatë dhe dokumentar filloi në vitin 1952 me themelimin e Kinostudios “Shqipëria e Re”. Një brez i tërë kineastësh mbaruan shkollat në ish-demokracitë e lindjes dhe shumë shpejt hodhën bazat e prodhimit kinematografik vendas. Në vitin 1953 u realizua filmi SKËNDERBEU në bashkëprodhim me “Mosk Film”. Në vitin 1957 u realizua filmi i parë i shkurtër shqiptar FËMIJËT E SAJ i regjisorit Hysen Hakani dhe më pas u realizua filmi i parë i gjatë TANA i regjisorit Kristaq Dhama. Këta filma shënuan fillimin e një procesi të vrullshëm e cila krijoi kushtet që kjo kulturë të trashëgohej në brezat e ardhshëm dhe të mbahet gjallë deri në ditët tona. Arti kinematografik i asaj kohe u zhvillua për interesa kryesisht ideologjike. Pavarësisht nga interpretimet që i shërbyen kohës së diktaturës, duke marrë në analizë fushën e gjerë të zhvillimit të këtij arti, mund të arrijmë në përfundim se kjo industri krijoi stabilitet dhe në disa raste arriti suksese ambicioze. Në vitet 80-të në Shqipëri arritën të xhiroheshin rreth 14 filma artistikë në vit, 30 dokumentarë dhe mbi 500 kronika, shifra këto të larta për çdo vend të rajonit, si dhe për vende të vogla perëndimore. Gjatë viteve të izolimit të tejskajshëm të vendit, arti kinematografik humbi orientimin bashkëkohor duke e bërë filmin shqiptar lokal dhe krejtësisht të veçuar nga avangardat e vendeve të tjera. Planifikimi i tematikave si rezultat i trilleve të politikave të kohës, solli bllokimin e të gjitha alternativave artistike.

Me rënien e diktaturës, pas viteve ‘90, autorë të rinj dhe me përvojë, duke u mbështetur në eksperiencën e industrisë së prodhimit kinematografik të viteve të mëparshëm, me motive dhe ambicje të reja artistike, filluan të punojnë për të plotësuar hapësirat e munguara në filmin shqiptar. Sot, komuniteti i kineastëve përballet me sfidat e reja për t’u bërë pjesë e industrisë kinematografike botërore. Vitet 2000 kanë sjellë suksese dhe frymë të re në kinemanë shqiptare, duke e klasifikuar atë në Kinemanë e Autorit, shumë të pasur me individualitete dhe filma eksperimentalë.

“New Albania” Film Studio was founded in 1952, feature length motion pictures and documentaries would soon be produced as well. An entire generation of filmmakers from Eastern European universities laid the foundations of national filmmaking upon returning to Albania. The feature length SCANDERBEG, of the year 1953, was co-produced with the Soviet “Mosfilm” studio. The first Albanian short film, FËMIJËT E SAJ (“Her Children”) was produced in 1957, by director Hysen Hakani; a year later, in 1958, director Kristaq Dhama shot Albania’s first feature length film, TANA. These events marked the beginning of an energetic process, which would create the conditions for the transmission, from one generation to another, of a national filmmaking culture and tradition. During the 1960-1980 period, filmmaking served ideological purposes, but the very systematic practice of the art created stability and wasn’t devoid of excellence. In the 1980s, Albania produced as many as 14 feature length films, 30 documentaries and over 500 newsreels - figures comparable to those of other countries in the region and other small countries in Western Europe. However, because the country was politically and culturally isolated from the rest of the world, Albanian filmmaking lost touch with contemporary cinema, and became provincial and impervious to avant-garde influences from other countries. As feature films had to deal with topics and subjects dictated by politics, all artistic alternatives were suppressed.

After the fall of communism in the early 1990s, young and not so young authors, based on the filmmaking experience gathered during previous decades, started to make up for the time and opportunities Albanian cinema had lost, with new motivation and ambition. Today, the community of Albanian filmmakers has to face new challenges, as it tries to make Albanian filmmaking part of the global filmmaking industry. The last decade has brought about international success and a new spirit to Albanian cinema, with several productions being of the Auteur category, enriching the national film scene with new individualities eager to find new forms of expression.

QENDRA KOMBËTARE E KINEMATOGRAFISË

THE ALBANIAN NATIONAL CENTER OF CINEMATOGRAPHY

Qendra Kombëtare e Kinematografisë (QKK) është krijuar në vitin 1997.

QKK është i vetmi institucion kombëtar që inkurajon, financon dhe promovon prodhimin kinematografik në Shqipëri. Përmes administrimit të fondit publik, QKK mundëson zhvillimin e industrisë së filmit në vendin tonë.

Qëllimi i QKK-së është zhvillimi i kinematografisë sonë duke inkurajuar vizionet e reja. Kriteri kyç në procedurën e përzgjedhjes së projekteve fituese mbetet vlera artistike. QKK që prej krijimit të saj, mbështet prodhimin, distribuimin dhe promovimin e filmave me metrazh të gjatë, të shkurtër, dokumentar dhe të animuar. QKK përkrah kineastët shqiptarë veçanërisht për bashkëprodhime ndërkombëtare. Kjo është një strategji efikase për të siguruar distribucion dhe një audiencë më të gjerë jashtë kufijve. QKK financon filma me metrazh të shkurtër të regjisorëve të rinj, si dhe ndihmon studentët kineastë në produksionet e tyre të para kinematografike.

QKK ofron mbështetje financiare për festivale filmi, organizon Ditë të Filmit Shqiptar në vende të tjera, si dhe seminare e konferenca që kontribuojnë në zhvillimin e industrisë së filmit në Shqipëri. QKK gjithashtu ndihmon edhe botimin e literaturës së artit filmik. QKK është përfaqësuese e Shqipërisë pranë strukturave ndërkombëtare kinematografike Eurimages, SEE Cinema Network dhe European Film Promotion dhe organizon pavione të filmit shqiptar në festivalet ndërkombëtare të filmit në Kanë dhe Berlin.

Filmat e realizuar me fondet e QKK kanë qënë të suksesshëm dhe janë nderuar me çmime në festivale të rëndësishme brenda dhe jashtë vendit.

The Albanian National Center of Cinematography (ANCC) was created in 1997.

The ANCC is the only national institution that encourages, finances and promotes Albania's motion picture production. Thanks to the administration of public funds, the ANCC helps to further the film industry in our country.

The ANCC's goal is to foster and advance Albanian cinema, encouraging new visions and emerging voices. As always, artistic merit will continue to be the most important criterion upon which these projects are selected. Since its creation the ANCC has supported production, distribution and promotion of feature films, shorts, documentaries and animations. The ANCC actively encourages Albanian filmmakers in developing feature film projects by financially supporting international co-productions, as a strategy to enhance distribution and reception of these films beyond our borders. ANCC finances short films made by up and coming directors along with film students making their first productions in order for them to see their efforts reach the big screen.

The ANCC financially assists film festivals along with presenting worldwide the 'Days of Albanian Cinema' – as well as valuable seminars, conferences and screenings meant to introduce and improve the film industry in Albania. The ANCC is also responsible for publishing many books on various Albanian cinematographic subjects. The ANCC represents Albania in a number of international motion picture organizations such as Eurimages, the SEE Cinema Network and the European Film Promotion. The ANCC is also responsible for organizing pavilions and booths which have promoted Albanian cinema in international film festivals, such as Cannes and Berlin.

The films co-produced by the ANCC have met with success, receiving nominations and winning prizes in important festivals, both inside and outside Albania.

Financuar nga / Financed by:

Qendra Kombëtare e Kinematografisë / Albanian National Center of Cinematography

Ministria e Turizmit Kulturës Rinisë dhe Sporteve / Ministry of Tourism Culture Youth and Sports

Bashkia Tiranë / Municipality of Tirana

Radio Televizioni Shqiptar / Albanian Radio Television

Me mbështetjen e / Supported by:

Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit / Albanian National Film Archive

Teatri Kombëtar i Komedisë / National Theater of Comedy

Teatri Kombëtar / National Theater

Galeria Kombëtare e Arteve / National Gallery of Arts

Teatri i Operas dhe Baletit / Theater of Opera and Ballet

Alba Film Studio, ish-Kinostudio “Shqipëria e Re” / Albafilm Studio (formerly ‘New Albania’ Film Studio)

Digitalb

Sponsor i Përgjithshëm / General Sponsor

RAJFI GROUP CONSTRUCTION

NËNTORI I DYTË hap Festivalin e 13^{të} të Filmit Shqiptar PREMIERË BOTËRORE e filmit të restauruar

The 13th Festival of Albanian Film - Opening Night Presentation: NËNTORI I DYTË (The Second November) – RESTORATION WORLD PREMIERE

Albania, 1982
79'

Qendra Kombëtare e Kinematografisë (QKK) në bashkëpunim me Arkivin Qendror Shtetëror të Filmit (AQSHF) ka nderin të hapë Festivalin e 13^{të} të Filmit Shqiptar me rastin e 100 Vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, me filmin NËNTORI I DYTË (1982) të restauruar në 35mm.

Filmi NËNTORI I DYTË është realizuar nga regjisori Viktor Gjika, një nga personalitetet më të njohur të kinematografisë shqiptare dhe interpretuar nga aktori i madh i skenës dhe ekranit, Sandër Prosi.

Hapja e festivalit me filmin NËNTORI I DYTË merr një rëndësi të veçantë, jo vetëm për trajtimin e historisë së Shpalljes së Pavarësisë në 28 Nëntor të vitit 1912, por edhe për shfaqjen për herë të parë të versionit të restauruar të këtij filmi.

Projekti për restaurim është vënë në jetë nga bashkëpunimi i AQSHF me Colorlab Corp., në Washington DC, Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Vëmendja dhe kujdesi i veçantë i inisiatorëve të këtij projekti bënë të mundur që publiku shqiptar të shohë 100 Vjetorin e ngjarjes që trajton ky film sipas standarteve ndërkombëtare.

The Albanian National Center of Cinematography (QKK) working in co-operation with the Central State Film Archive of Albania (AQSHF) is honored to open the '13th Festival of Albanian Film in the 100th Independence Year' with a restored 35mm print of Viktor Gjika's THE SECOND NOVEMBER (1982).

THE SECOND NOVEMBER is directed by Viktor Gjika, one of the most distinguished figures in Albanian cinema and stars Aleksander 'Sander' Prosi in his towering performance as the great patriot, Ismail Qemal Vlora, has always occupied a unique place in Albania's cultural history.

Opening the festival with this film is important not only because this period piece chronicles the dramatic obstacles that Ismail Qemali had to overcome to declare Albania's fledgling independence from Turkey, but because it comes for the first time in a restored form.

This restored print of THE SECOND NOVEMBER was completed with professional attention and care by the Colorlab company in Washington DC. Working with the original elements, the Colorlab technicians were able to take the negative and

Regjia/Director: Viktor Gjika
Skenari/Script: Dhimiter Shuteriqi, Kiço Blushi
Muzika/Music: Kujtim Laro
Rolet/Cast: Sander Prosi, Bujar Lako, Reshat Arbana, Viktor Zhusti, Mario Ashiku, Robert Ndrenika, Guljelm Radoja, Demir Hyskja, Pandi Raidhi, Vangjel Heba, Vangjel Grabocka, Sulejman Dibra
Kinostudio "Shqipëria e Re"



Duke punuar me elementet origjinale teknicienët e Colorlab, arritën të nxjerrin nga negativi i mëparshëm një version të ri me ngjyra brilante dhe zë të pastruar. Për më tepër, Colorlab punoi bashkë me AQSHF për krijimin e këtij versioni me subtitrim në gjuhën angleze. Kjo është hera e parë që ky film do të ketë mundësinë të shfaqet i subtitruar, të distribuohet dhe të shijohet nga shikues kudo në botë.

Shfaqja e këtij filmi do të shërbejë gjithashtu për rritjen e vëmendjes, jo vetëm për ruajtjen dhe kujdesin për filmat e arkivuar në AQSHF, por edhe për vazhdimin e iniciativave të tilla për restaurimin e filmave të rëndësishëm të kinematografisë shqiptare.

Kjo do t'i shërbejë ruajtjes së historisë së kombit tonë të fiksuar në celuloid, por edhe do të rrisë cilësinë e veprave më të mira të lëna trashëgimi nga brezat e kineastëve.

Organizatorët e Festivalit dëshirojnë të falenderojnë Znj. Elvira Diamanti, drejtoreshë e AQSHF, si dhe gjithë anëtarët e stafit, mes tyre dhe Znj. Eriona Vyshka dhe Hermelinda Troqe, Flori Balliu, Andi Lubonja, për përkujdesin e tyre të vazhdueshëm që mundësoi realizimin e këtij projekti.

Organizatorët e Festivalit gjithashtu falenderojnë për punën dhe pasionin e madh për kinemanë, regjisorët Iris Elezi, Thomas Logoreci dhe në mënyrë të veçantë arkivistin Regina Longo, pa iniciativën dhe punën e palodhur të të cilëve, ky projekt nuk mund të realizohej.


create a new version of Viktor Gjika's film with vivid colors and improved sound.

Most importantly, Colorlab has worked with the AQSHF to create an English language subtitled print. This is the first time that this film will be viewed with English subtitles, and THE SECOND NOVEMBER can now be distributed and enjoyed by audiences worldwide.

This screening will serve towards raising higher awareness about the cultural, artistic and historical significance of preserving Albania's cinematic legacy and to continue such initiatives for the restoration of key Albanian films. For this is the biggest test and dream of the AQSHF: to strike new prints of all the motion pictures that Albania has produced.

The festival would like to thank all the staff of the AQSHF with special mention to Eriona Vyshka, Hermelinda Troqe, Flori Balliu, Andi Lubonja, and the head of the archive, Elvira Diamanti for their attention and care that made this unique event possible. Though great strides have been made in a short time with support from many archives and laboratories worldwide, there is still much to be done.

The festival also wishes to thank for their hard work and passion for the cinema, the filmmakers Iris Elezi and Thomas Logoreci, and especially the archivist Regina Longo, whose initiative and spirit made this project possible.



ANIJA - PREMIERË BOTËRORE THE SHIP - WORLD PREMIERE

Dokumentar/Documentary, Albania-Italy

83'

Në ditët e para të Marsit 1991, në horizontin e bregut Adriatik të Italisë u shfaqën disa anije të cilat do të shënonin atë që do të quhej “eksodi i shqiptarëve”. Ky është rrëfimi i një udhëtimi, anijesh dhe njerëzish, që shërben për rindërtimin e tre eksodeve të mëdha të shqiptarëve. ANIJA e nis udhëtimin e vet përpara mbërritjes në Itali, duke u përqendruar tek rruga që çon drejt anijes, tek ngjitja në anije, në përpjekje për të nxjerrë prej aty fytyrat dhe përvojat vetiake në udhëtimin e tyre të vërtetë e njëkohësisht metaforik për kapërcimin e detit.

In the early days of March 1991, a number of ships arrived on Italy's Adriatic shores, marking what would later be known as the 'Albanian Exodus'. This is the story of a journey; the story of the ships and the people who fled on them, in an attempt to recreate the three great Albanian migrations. THE SHIP begins its voyage before setting sail, by focusing on the path that brought these people to the ships, climbing on board, trying to extract from their faces and personal experiences during the real as well as metaphoric voyage, while crossing the sea.

ROLAND SEJKO

r.sejko@gmail.com



I lindur në Elbasan në 1968, Roland Sejko u diplomua në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë në Universitetin e Tiranës përpara se të vendosej në Itali në vitin 1991, ku punon pranë Institutit Luce (shtëpia filmike më e vjetër në Itali) dhe merret me aktivitete të ndryshme si arkivist, prodhim dhe distribucion filmash. Që nga viti 1999, Sejko ka themeluar dhe drejton gazetën në shqip, të përdyjavshmen “Bota Shqiptare” për komunitetin shqiptar në Itali. Në 2008, Roland Sejko shkruajti dhe bashkëdrejtoi me Mauro Brescia filmin e sukseshmëm dokumentar IL PAESE DI FRONTE (Vendi përballë) ku materiali arkivor i përzgjedhur shërben si kronikë e historisë së Shqipërisë.

Born in Elbasan, Albania in 1968, Roland Sejko graduated from the Faculty of History and Philology at the Tirana University before settling in Italy in 1991, where he has been working since for Istituto Luce (Italy's oldest filmhouse) with activities ranging from historical film archiving, feature film production and distribution. Since 1999, Sejko has founded then directed the Albanian-language fortnightly 'Bota Shqiptare' (The Albanian World) for the Albanian community in Italy. In 2008, Roland Sejko wrote and co-directed (w/Mauro Brescia) the successful documentary IL PAESE DI FRONTE (The Country Across), a feature that chronicled Albania's history using archival footage.

FILMOGRAFI

Shqipëria, vendi përballë / Albania, The Country Across



Regjia/Director: Roland Sejko

Skenari/Script: Roland Sejko

Fotografia/DP: Sabrina Varani

Montazhi/Editor: Luca Onorati

Muzika/Music: Robert Bisha

Zëri/Sound: Gianluca Scarlata

Producent/Producer: Ketë Biçoku

Prodhuar nga/Produced by: Propaganda-Al,
Istituto Luce Cinecittà-It

Financuar nga/Finnanced by: Qendra Kombëtare
e Kinematografisë/ANCC, MIBAC, Direzione
Generale Cinema, Film di Interesse Culturale,
Ambasciata d'Italia in Albania



Regia/Director: Rachel Goslins
Fotografia/DP: Neil Barrett
Montazhi/Editor: Christine S. Romero
Muzika/Music: Philip Glass
Producent/Producer: Jason Williams, Bill Morgan, Rachel Goslins, Christine S. Romero
besathepromise.com



BESA: PREMTIMI - PREMIERE EUROPIANE **BESA: THE PROMISE - EUROPEAN PREMIERE**

Dokumentar/Documentary, USA, Bulgaria, Israel, Albania
 90'

Viti 1939. Lufta afrohet në horizont. Shumë hebrenj gjermanë kërkojnë strehë larg situatës dëshpëruese në vendlindjen e tyre. Ndërsa pjesa më e madhe e Europës u kthen kurrizin, Shqipëria ofron azil të pakushtëzuar. Mbreti Zog shpall që të gjithë hebrenjtë që jetojnë në Shqipëri mund të marrin nënshtetësi. Atë vit trupat fashiste Italiane pushtojnë vendin dhe Mbreti Zog nisët në mërgim. Jeta e hebrenjve vihet në rrezik. Në këtë situatë familjet shqiptare, shumica myslimane, dhanë besën e tyre, premtimin e patundur për t'i mbrojtur

1939. War looms on the horizon. Many German Jews were looking for refuge from the desperate situation at home. While the rest of Europe turned its back, Albania offered unconditional asylum. King Zog announced that all Jews residing in Albania could obtain citizenship. That year, fascist troops invaded, sending the king into exile and putting the Jews in jeopardy. In response Albanian families, most of them Muslim, gave their sacred oath, the ancient besa, to protect the refugees.

refugjatët. Me përshkallëzimin e luftës refugjatët hebrenj u detyruan të braktisnin mikpritësit e tyre. Familja Aladjems përpara se të largohej i la në BESE librin e shenjtë të lutjeve familjes së babait të Rexhep Hoxhës, i cili premtoi që do kujdesej për të deri sa dikush të kthehej sërish në Shqipëri.

Në vitin 2002, Norman Gershman udhëtoi në Shqipëri për të fotografuar familjet që shpëtuan hebrenjtë. Për të përmbushur këtë premtim 66 vjeçar, Gershman ndihmoi Rexhep Hoxhën të shkojë në Izrael e të takojë pjesëtarët e familjes që strehoi babai i tij 43 vjet më parë.

Besa: Premtimi është një film që reflekton me mjeshtëri dhe nxjerr në pah këtë shembull historik të mrekullueshëm të solidaritetit njerëzor.

Muzika është kompozuar nga kompozitori i mirënjohur Philip Glass.

In 2002, Norman Gershman journeyed to Albania to photograph the families who rescued Jews. There he met Rexhep Hoxha, the son of a pastry chef who had hidden a family of Bulgarian Jews, the Aladjems, in his home. The refugees had been forced to leave behind their sacred prayer books, and Hoxha's father pledged to keep them till the Aladjems could someday return to Albania. Bringing the circle to a close, Gershman helps Hoxha go to Israel, allowing him to fulfill the 66-year-old promise to the Jewish family he sheltered.

BESA: THE PROMISE is a powerful look at a historic example of basic human solidarity.

Featuring music by master composer Philip Glass.

RACHEL GOSLINS

Dokumentari i fundit i regjisores dhe producentes Rachel Goslins, BAMA GIRL, pati premierën në SXSW në 2008 dhe u transmetua në IFC. Filmi i saj i parë i shkurtër, ONDERDUIKEN, tregon historinë e familjes së saj në Hollandë gjatë Luftës së Dytë Botërore kur ata fshiheshin nga nazistët. Ajo ka prodhuar filma për kanalet National Geographic, Discovery, PBS, A&E dhe History. Ka punuar si drejtoreshë e International Digital Distribution Lab, projektit të PBS/ITVS, që fokusohet në distribuimin e filmave të pavarur online. Aktualisht Rachel Goslins është Drejtoresha Ekzekutive e Komitetit të Artit të Presidentit Barack Obama.



Director, producer Rachel Goslins most recent feature documentary, BAMA GIRL, premiered at SXSW in 2008 and aired on IFC. Her first short film, ONDERDUIKEN, was about her family's history in Holland hiding from the Nazi's during WWII. She has made films for National Geographic, Discovery, PBS, A&E and History. She was also the Director of the International Digital Distribution Lab, a joint PBS/ITVS project focused on distributing independent films online. Rachel Goslins is presently Executive Director of President Barack Obama's Committee on Arts and Humanities.

JURIA E FILMIT TË GJATË / FEATURES JURY

MUHARREM FEJZO

Skenaristi dhe regjisori veteran Muharrem Fejzo lindi në Kolonjë në vitin 1933. Ndërsa studionte për skulpturë, Fejzo bëri praktikë si sufler në Teatrin Popullor në Tiranë. Ai gjithashtu kreu studimet në degën e aktrimit dhe nga pasioni i madh që kishte për kinemanë, Muharrem Fejzo kontribuoi si grimier në disa nga filmat e parë shqiptarë. Vite më vonë u bë drejtori i Shtëpisë së Kulturës në qytetin e Kukësit. Përpara se të realizonte filmin e tij të parë, MONTATORJA (1970), Fejzo punoi si asistent regjisor në dy filma artistikë, PRITA (1968) të Mithat Fagut dhe NJËSITI GUERRIL (1969) të Hysen Hakanit. Në vitin 1972 Muharrem Fejzo, së bashku me regjisorin Fehmi Hoshafi, realizoi filmin KAPEDANI, komedinë e parë që vazhdon të konsiderohet edhe sot si një nga kryeveprat e kinemasë shqiptare. Udhëtimi komik i luftëtarit të vjetër, Sulo (Albert Verria), që nuk e pranon emancipimin e gruas në epokën socialiste, mbetet një nga filmat më të dashur për spektatorin. Gjatë karrierës së tij, regjisori Muharrem Fejzo realizoi mbi dhjetëra filma të tjerë, midis të cilëve mund të përmenden OPERACIONI ZJARRI (1973) dhe MËSONJËTORJA (1979). Filmin e tij të fundit MURI I GJALLË, Muharrem Fejzo e realizoi në vitin 1989.



Veteran writer and film director Muharrem Fejzo was born in Kolonjë, Albania on 1933. Young Fejzo first studied to be a sculptor while interning as a call boy at the National Theater in Tirana, eventually becoming the director of the culture house in the northern city of Kukës. Eager to break into the movies, Muharrem Fejzo began working as a make-up artist in some of the earliest Albanian features while pursuing acting studies. Fejzo turned to assistant directing on two features, Mithat Fagu's PRITA (1968) and Hysen Hakani's NJËSITI GUERRIL (1969), before making his directing debut with the 1970 MONTATORJA. In 1972, co-directing with Fehmi Hosafi, Muharrem Fejzo made the black and white KAPEDANI, considered to be one of the masterpieces of Albanian cinema and the very first comedy made during the communist era. The comic journey taken by the old warrior Sulo (Albert Verria) who is unable to accept the advances of women in the socialist era has become one of the most popular and beloved films in the nation's history. Fejzo went on to direct a dozen more feature films including the acclaimed OPERACIONI ZJARRI (1973) and MËSONJËTORJA (1979) concluding his career with the 1989 drama MURI I GJALLË.

AUREL PLASARI


Aurel Plasari i ka kryer studimet e larta në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë të Universitetit të Tiranës, ku edhe ka doktoruar dhe ka marrë titullin "Profesor". Aurel Plasari është autor studimesh letrare e historike, shkrimtar, publicist dhe përkthyes. Aktualisht ai është drejtor i Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë (Tiranë) dhe pedagog i Estetikës në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, si edhe lektor në INALCO (Paris). Aurel Plasari ka kryesuar disa juri për konkurse letrare kombëtare si dhe ka qenë anëtar i disa jurive ndërkombëtare. Ka marrë çmime dhe vlerësime kombëtare e ndërkombëtare, si dhe Urdhërin e Meritës të Republikës Italiane. Aurel Plasari është anëtar i Komitetit Ndërmintor për 100-vjetorin e Pavarësisë.



Aurel Plasari studied history and completed his PhD at the University of Tirana. He's an author of various literary and historical studies, a publicist and translator. Plasari is a professor of esthetics in the History and Philology Department at the University of Tirana, a lecturer at INALCO (Paris) and is also currently serving as Director of the National Library of Albania. He's led the juries of many national literary competitions and has also himself been a member of many international juries. He has received national and international commendations including the Order of Merit from the Italian Republic. Aurel Plasari is also serving on the 100 Years of Independence Ministries Committee.

MARK COUSINS


Mark Cousins është regjisor Irlandez, autor, kritik dhe kurator. Katër librat e tij mbi kinemanë janë publikuar në shumë vende të botës. Cousins ka bashkë-drejtuar katër evente filmike si dhe Fondacionin 8 e ½ me aktoren e mirënjohur, fituese të Oskarit, Tilda Swinton. Në serinë e tij televizive të transmetuar në BBC nga viti 1996 në 2001, ai ka intervistuar midis të tjerëve edhe disa nga mjeshtrit e mëdhenj të artit kinematografik, si Martin Scorsese, David Lynch, Woody Allen dhe Brian De Palma. Mark Cousins ishte drejtor i Festivalit të filmit të Edinburgut, të cilin e zhvendosi në Sarajevo gjatë rrethimit të qytetit. Ai ka prodhuar dy filma të rinj. THE STORY OF FILM - AN ODYSSEY me kohëzgjatje prej 15 orësh që u shfaq në Festivalin e Filmit të Torontos, në Berlin dhe në Muzeun e Artit Modern në New York. Filmin tjetër WHAT IS THIS FILM CALLED LOVE? (Çfarë është ky film i titulluar dashuri?) Mark Cousins e prodhoi për vetëm shtatë Euro dhe premierën në Festivalin e Filmit Karlovy Vary në 2012.



Mark Cousins is an Irish filmmaker, author, critic and curator. His four books on cinema have been published around the world. Cousins has co-directed four innovative film events and the 8 and ½ Foundation with Academy Award winning actress Tilda Swinton. He has interviewed many of the masters of the motion picture craft including Martin Scorsese, David Lynch, Woody Allen and Brian De Palma for his BBC television series which aired from 1996 to 2001. Mark Cousins was director of the Edinburgh International Film Festival, which he took to Sarajevo during the siege. He has two recent new films. THE STORY OF FILM - AN ODYSSEY was shown in its fifteen hour entirety in the Toronto film festival, Berlin and the Museum of Modern Art in New York. His new film, WHAT IS THIS FILM CALLED LOVE? was made with a budget of seven Euros and premiered at the 2012 Karlovy Vary film fest.

ISA QOSJA


Regjisori i njohur i filmit, teatrit dhe televizionit, Isa Qosja, gjithashtu skenarist dhe aktor, lindi në Vuthaj të Malit të Zi, në ish-Jugosllavi, në 1947. Qosja filloi studimet për aktrim në Prishtinë, Kosovë. Më pas ai studio regji filmi dhe televizioni në Beograd. Nga fundi i viteve 1970, Qosja u bë i njohur jo vetëm për filmat e tij të shkurtër dhe dokumentarë, por edhe si një nga regjisorët më të shquar të artit skenik. Reputacioni i Isa Qoses si një nga regjisorët më të mirë të rajonit u rrit nga suksesi i dy filmave të tij të parë artistik, PROKA (1985) dhe ROJET E MJEGULLËS (1988). PROKA fitoi çmimin e madh (grand prize) në Recontres Internationales Film et Jeunesse (RIFJ) në Mougins (Cannes), France. Filmi i tij i fundit, drama komedi KUKUMI (2005), e vendosi regjisorin në vëmendjen e shikuesve dhe kritikëve ndërkombëtarë. Me këtë film, Isa Qosja në vitin 2006 fitoi çmimin e regjizorit dhe filmit më të mirë në Festivalin e 12-të të Filmit Shqiptar. I prodhuar me një buxhet të vogël ky film u shfaq në festivalin e Venecias dhe fitoi çmimin special të jurisë në Festivalin e Sarajevës dhe çmimin e madh në Festivalin e Sofies.



Accomplished film, theater and television director, screenwriter and actor ISA QOSJA was born in Vuthaj, Montenegro in the former Yugoslavia in 1947. Qosja originally took up dramatic acting in Prishtina, Kosovo before departing to the capital, Belgrade, to pursue studies in motion picture and television direction. Beginning in the late 1970's, Qosja not only made documentaries and short fiction films, but also established himself as Kosovo's preeminent director of the theatre stage. Isa Qosja's debut feature PROKA (1985) and its dramatic follow-up ROJET E MJEGULLËS (1988) cemented his reputation as the region's top film director. PROKA went on to win the grand prize at the Recontres Internationales Film et Jeunesse (RIFJ) in Mougins (Cannes), France. Isa Qosja's dark comedy drama KUKUMI (2005), gave the filmmaker international audience and critical attention. In 2006, Isa Qosja won both 'Best Film' and 'Best Director' at the 12th Festival of Albanian Film. Produced with a low budget, the film went on to win prestigious awards at Sarajevo (special jury prize) and Sofia (grand prize) and played at numerous festivals worldwide including competition in Venice.

CLAUDIO FRAGASSO

Regjisor dhe autor i njohur i filmit dhe i televizionit, lindi në Itali në vitin 1951. Claudio Fragasso ka realizuar mbi 24 filma artistikë. Ai është vlerësuar nga kritika dhe publiku për filmin i tij neo-realist *TESTE RASATE* (1993) i cili gjeneroi një debat të gjerë publik për trajtimin e neonazistëve në Italinë e viteve '90. Fragasso njihet në publikun shqiptar prej filmave *PALERMO MILANO SOLO ANDATA* (1995) dhe *MILANO PALERMO IL RITORNO* (2007). Ndër serialet televizive që janë realizuar prej tij mund të përmendim *OPERAZIONE ODISSEA* (1999), *BLINDATI* (2000), *LA BANDA* (2001), *CONCORSO DI COLPA* (2004). Filmi i tij *LE ULTIME 56 ORE* (2010) fitoi Festivalin e Filmit të Messinës dhe Napoli Culture Classic. Në vitin 2012 ka realizuar *NOTTE DA PAURA*, *OPERAZIONE VACANZE*, një komedi mbi pushimet e verës prej së cilës italianët nuk duan të heqin dorë edhe në kohë krize. Ky ishte prodhimi i vetëm italian në Top Listën e dhjetë filmave të verës në Itali. Në dy vitet e fundit Claudio Fragasso është profesor në shkollën e mirënjohur italiane “Centro sperimentale nazionale di cinematografia”.




Noted screenwriter and director of film and television, born in Italy in 1951. Claudio Fragasso has made over 24 feature length films. Audiences and critics embraced his neo-realist *TESTE RASATE* (1993) which generated public debate about the neo-Nazi problem in Italy. Fragasso's work is familiar to the Albanian public through such films as *PALERMO MILANO SOLO ANDATA* (1995) and *MILANO PALERMO IL RITORNO* (2007). Among his many television series are *OPERAZIONE ODISSEA* (1999), *BLINDATI* (2000), *LA BANDA* (2001), and *CONCORSO DI COLPA* (2004). His film *LE ULTIME 56 ORE* (2010) was the winner of the Napoli Culture Classic and the Messina Film Festival. In 2012 he produced *NOTTE DA PAURA*, *OPERAZIONE VACANZE*, a summer comedy about Italians unwilling to give up on their vacations despite the economic crisis. In 2012, *VACANZE* was the only Italian production in the top ten list of summer box office successes in Italy. As of these past two years, Claudio Fragasso is a professor at the renowned school “Centro sperimentale nazionale di cinematografia” in Italy.

JURIA FILMAVE TË SHKURTËR DOKUMENTARË & VIZATIMORË SHORT, DOCUMENTARY & ANIMATION JURY

ASTRIT ALIHAJDARAJ

Astrit Alihajdaraj lindi në Istog të Kosovës në 1976. Ai studio për aktrim në Vienë, pas shpërnguljes në Austri në vitin 1996. Roli i tij i parë ishte i një prej protagonistëve në dramën e suksesshme NORDRAND të regjisores Barbara Albert, në vitin 1999. NORDRAND konsiderohet si një nga filmat austriakë më të mirë prodhuar deri tani dhe konkurroi në shumë festivale të rëndësishme, përfshirë këtu edhe atë të Venecias. Më pas Alihajdaraj ka aktruar në disa filma të gjatë e të shkurtër, seriale televizive dhe shfaqje teatrale, si DIE ENTSCHEIDUNG (2006) të Nikolaus Leytner, BALKAN TRAFFIC (2008) të Milan Puzic dhe Markus Sein dhe ILIRIANA (2009) të Ernest Mehollit. Astrit Alihajdaraj është gjithashtu duke zhvilluar një skenar të tijin të titulluar, A JOURNEY TO EUROPE.



Astrit Alihajderaj was born in 1976 in Istog, Kosovo. In October 1996 he relocated to Vienna, Austria where he pursued acting studies. In 1999, Alihajdaraj made his feature film acting debut with Austrian director Barbara Albert's acclaimed drama NORDRAND which competed in many festivals worldwide including competition in Venice. Since then, he has appeared in dozens of other features, shorts, theatrical productions and television series including Nikolaus Leytner's DIE ENTSCHEIDUNG (2006), Milan Puzic and Markus Sein's BALKAN TRAFFIC (2008) and Ernest Meholli's ILIRIANA (2009). Apart from acting, Astrit Alihajdaraj is currently developing a screenplay he's written tentatively titled A JOURNEY TO EUROPE.

MUJË BUÇPAPAJ

Mujë Buçpapaj është autor, publicist dhe skenarist, i lindur në 1962 në Tropojë. Ai u diplomua për gjuhë dhe letërsi shqipe në Universitetin e Tiranës. Pas një përvoje të shkurtër si mësues, ai kreu studimet pasuniversitare për skenar të filmit artistik pranë Kinostudios "Shqipëria e Re". Mujë Buçpapaj është autor i disa skenarëve për dokumentarë televizivë dhe spektakle. Mujë Buçpapaj njihet si autor i disa përmbledhjeve poetike, një pjesë e të cilave është botuar dhe në gjuhë të huaja. Këto 15 vjet ka kontribuar në shtypin qendror të Tiranës si dhe ka përkthyer kryesisht poezi bashkëkohore amerikane. Mujë Buçpapaj gjatë viteve 2005 - 2012 ka qënë Drejtor i Përgjithshëm i Qendrës Ndërkombëtare të Kulturës "Pjetër Arbërori", gjatë së cilës i dha prioritet arteve të performuara, filmit shqiptar dhe atij të huaj. Prej korrikut 2012, Buçpapaj punon si drejtor i Zyrës Shqiptare të të Drejtave të Autorit në Tiranë.



Born in Tropoja in 1962, Mujë Buçpapaj is an Albanian author, publicist and screenplay writer. Buçpapaj graduated in Albanian studies from the University of Tirana. He briefly pursued a career as a teacher before moving on to study screenplay writing at the Kinostudio "New Albania". Mujë Buçpapaj has written scripts for many television documentaries and specials. He is renowned for his poetry and his collections have been translated abroad. During the past 15 years, he has contributed to Tirana's central press and continues to translate contemporary American poetry. During 2005-2012, Mujë Buçpapaj was director of Qendra Ndërkombëtare e Kulturës "Pjetër Arbërori", where he focused on programming performing arts and film events. Since July 2012, Buçpapaj has served as the director of the Albanian copyright office in Tirana.

ARBEN ZHARKU

Arben Zharku është producent dhe aktor i lindur në Kaçanik të Kosovës në vitin 1982. Ai u diplomua për artin dramatik në Fakultetin e Arteve, në Universitetin e Prishtinës. Zharku është një nga themeluesit dhe një nga drejtuesit e të përvitshmit SKENA UP - Festival i Studentëve të Filmit dhe Teatrit në Prishtinë, Kosovë. Arben Zharku është gjithashtu menaxher i Qendrës Multimedia Prishtina, e cila zhvillon projekte artistike vizuale dhe performancë. Në 2009 Zharku, bashkë me Jeton Neziraj, krijoi “Qendra Productions”, një kompani filmike, qëllimi i së cilës është mbështetja e talenteve të reja si dhe rritja e bashkëprodhimeve ndërkombëtare me Kosovën. Arben Zharku prodhoi dhe aktroi në filmin e gjatë artistik të regjisorit irlandez Brendan Grant TONIGHT IS CANCELLED(2007). Në 2009, Zharku u diplomua nga program European Audiovisual Entrepreneurs (EAVE). Prej vitit 2011, Arben Zharku kryen funksionin si Drejtues i Bordit të Qendrës Kinematografike të Kosovës.



